

Workshop i organizuar nga SIGMA dhe CEF në Lubjanë për ‘Përmirësimin e shkrimit të raporteve’ me Institucionet Supreme të Auditimit kandidate dhe kandidate potenciale

SIGMA dhe CEF organizuan në Lubjanë, në datat 7 dhe 8 nëntor workshop-in me rrjetin e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale me temë ‘Përmirësimi i shkrimit të raporteve’. Ky workshop u mbështet gjithashtu edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO).

Takimi u hap nga fjala përshëndetëse e Drejtoreshës së CEF Znj.Jana Repansek, e cila prezantoi konceptin ‘How public institutions can become a learning organisation’, që aplikohet në CEF, si dhe Znj.Bianca Breteche, Zëvendës Drejtuese e SIGMA-s.

Organizatorët dhe institucionet homologe pjesëmarrëse patën mundësinë të prezantonin dhe ndanin në këtë tryezë jo vetëm parimet dhe elementët e të shkruarit efektiv të raporteve të auditimit, hartimit dhe implementimit të guidave të përdorimit të gjuhës së thjeshtë dhe miqësore me lexuesin dhe grupet e interesit, por edhe evidentimin e barrierave në këtë proces, risqeve gjatë aplikimit, oportuniteteve dhe pozicionimin e secilit Institucion Suprem Auditimi (SAI) për të gjitha këto aspekte.



Nën dritën e eksperiencës së sjellë nga Gjykata Europiane e Llogarive (ECA), SNAO dhe SAI-t e rrjetit u ngritën tryeza diskutimi, të cilat konkluduan në përfundim me sugjerime konkrete për SAI-t dhe rrjetin me qëllim zhvillimin e praktikave të shkrimit të mirë të raporteve në vijimësi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim u përfaqësua nga Znj.Valbona Gaxha, Sekretare e Përgjithshme dhe Znj.Xhesika Xhuveli, Audituese e Lartë në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit.